

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 728 Rep.
NR. 239 Kol.



MARRËVESHJE

“PËR ZGJIDHJEN ME KONSENSUS TË KONTRATËS SË KONCESIONIT
TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “PROGONAT – LEKDUSH” DHE
“BËNÇE E SIPËRME”

(KONTRATA E KONCESIONIT NR. 1638 REP., NR. 424/2 KOL., DATË 26.03.2009
NDRYSHUAR ME KONTRATËN SHITESË NR. 270 REP., NR. 146 KOL., DATË 10.05.2012)

Në Tiranë, më datë 06 muaji MARS, viti 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noter
anëtar i dhomës së Noterisë Tirane, me adresë
, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që në vijim do të citohet “MIE”, në cilësinë e
Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga me autorizimin nr. 30711/prot. datë 13/10/2018 nga
Znj. F. shtetase shqiptare, lindur ne me , banuese ne Tirane,
mbajtes i leternjofimit ID me nr. personal nr. Leternjofimi (, madhor
me zotësi te plote juridike për të vepruar.

DHE

Shoqëria GEOENERGIE S.P.A. (ish Radici Energie S.p.A.) shoqëri e së drejtës italiane, me
seli në Bergamo (Itali), Via Verdi nr. 11, e regjistruar në Regjistrin e Ndërmarrjeve në Bergamo
me kod fiskal 00998130165 dhe me nr. BG-284774 R.E.A (me NIPT 02384370165), qe me
poshte do te quhet koncesionari, përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë të posaçme nga, z.
, qytetar italian, madhor në moshë, i lindur në (Itali) më datë
, me banim në l , mbajtës i kartës e
së identitetit nr. , i pajisur me tagrat e duhura nga prokura e posaçme nr rep :
datë dhe vendimi i këshillit të administrimit

DHE

Shoqëria "GEOALBANIA UNO" Sh.p.k. shoqëri e së drejtës shqiptare, me seli në Rruga Abdi
Toptani, Torre Drin, Kati II, Tiranë Shqipëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit
Tiranë me NUIS L02212002F, qe me poshte do te quhet shoqeria koncesionare, përfaqësuar nga
administratori dhe përfaqësuesi ligjor, z. qytetar italian, madhor në moshë, i
lindur në () më datë (me banim në (Via
, mbajtës e pasaportës nr. i pajisur me tagrat e duhura nga
vendimi i asamblesë së përgjithshme datë (

Palët të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë marrëveshje për zgjidhjen me konsensus të Kontratës të Koncesionit të formës "BOT" (ndërtim-operim-transferim), të nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE) dhe Shoqëria Radici Energie S.p.A. (sot GEOENERGIE S.P.A.) më datë 26.03.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve "Progonat – Lekdush" dhe "Bënçe e Sipërme" (Kontrata e Koncesionit nr. 1638 rep. nr. 424/2 kol. datë 26.03.2009 ndryshuar me Kontraten Koncesionare Shtesë të nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqëria Koncesionare "GEOALBANIA UNO" Sh.p.k. më datë 10.05.2012 me Nr. 270 Rep., Nr. 146 Kol. datë 10.05.2012.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT", (ndërtim-operim-transferim), të nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE) dhe Shoqëria Radici Energie S.p.A. (sot GEOENERGIE S.P.A.) më datë 26.03.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve "Progonat – Lekdush" dhe "Bënçe e Sipërme" (Kontrata e Koncesionit Nr. 1638 Rep., Nr. 424/2 Kol. datë 26.03.2009 ndryshuar me Kontratën Koncesionare Shtesë të nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqëria Koncesionare "GEOALBANIA UNO" Sh.p.k. më datë 10.05.2012 me Nr. 270 Rep. Nr. 146 Kol. datë 10.05.2012, në pikën 5 të nenit 12 "Zgjidhja e Kontrates me Konsensus" cilësohet se: "*Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar menyrën e kompensimit të investimit. Gjithsesi, Koncesionari ka të dejtë të kërkojë sigurimin e Kontratës nëse ekziston*".
- Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare, me anë të shkresës Nr. Prot 13/2017/MDP/ss datë 30.03.2017, protokolluar pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot MIE) me nr. 2076 prot. datë 04.04.2017, drejtuar Autoritetit Kontraktues nepermjet se ciles ka kërkuar zgjidhjen me konsensus të Kontratës Koncesionare, bazuar në nenin 12.5 të saj.
- Në vijim të ftesës për takim bazuar në shkresën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot MIE) me nr. 2076/3 prot. datë 06.07.2017, palët kanë realizuar më datë 07.07.2017, pranë ambienteve të Autoritetit Kontraktues takimin, me anë të të cilit përfaqësuesit e Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare kanë paraqitur argumentat mbi problematikat e hasura dhe shkaqet e kërkesës, si dhe lidhur me propozimin për zgjidhjen e kontrates me konsensus
- Autoriteti Kontraktues, me anë të shkresës nr. 3071/1 prot. datë 31.01.2018 drejtuar Shoqërisë Koncesionare ka shprehur dakordësinë në lidhje me zgjidhjen me konsensus të Kontratës Koncesionit, bazuar në nenin 12.5 të saj, sipas kërkesës/propozimit të Koncesionarit.

Për këto arsye,

Bazuar në nenin 12.5 të Kontratës së Koncesionare Nr. 1638 Rep., Nr. 424/2 Kol. datë 26.03.2009, Palët bien dakord sa më poshtë vijon:



Neni 1

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Palët bien dakord që të zgjidhin dhe zgjidhin efektivisht me konsensus Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (ndërtim-operim-transferim), të nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqëria Radici Energie S.p.A. (sot GEOENERGIE S.P.A.) më datë 26.03.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve "Progonat – Lekdush" dhe "Bënçe e Sipërme" (Kontrata e Koncesionit Nr. 1638 Rep., Nr. 424/2 Kol. datë 26.03.2009 ndryshuar me Kontraten Koncesionare Shtesë të nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqëria Koncesionare "GEOALBANIA UNO" Sh.p.k. më datë 10.03.2012 me Nr. 270 Rep., Nr. 146 Kol. datë 10.05.2012).

Neni 2

Shoqëria Koncesionare me këtë akt i dorëzon Autoritetit Kontraktues i cili pranon, pa ndonjë kundërshtim, sa vijon:

- të gjitha asetet e realizuara prej saj, si aktive afatgjate materiale, siç rezultojnë nga pasqyrat financiare të vitit 2016 të Shoqërisë Koncesionare;
- të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike;
- çdo të drejtë tjetër të fituar prej saj nëpërmjet Kontratës së Koncesionit.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë kërkesë për detyrime financiare përkundrejt njëra-tjetrës dhe heqin dorë nga çdo pretendim përkundrejt njëra-tjetrës në lidhje me Kontratën e Koncesionit dhe zgjidhjen e saj.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Autorteti Kontraktues sipas gjykimit të tij ka të drejtën ta riçelë përsëri garën konkuese për zhvillimin e këtij projekti qoftë edhe në mënyrë pjesore.

Neni 3

Koncesionari merr përsipër të zbatojë të gjitha modalitetet juridike të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar, për likuidimin e Shoqërisë Koncesionare "GeoAlbania Uno" Sh.p.k., të krijuar në bazë të nenit 8 të Kontratës së Koncesionit dhe çregjistrimin e saj në QKB, bazuar në kuadrin ligjor mbi bazën e të cilit operon ky institucion.

Neni 4

Kjo Marrëveshje, hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje pushojnë efektet ligjore të Kontratës së Koncesionit Nr. 1638 Rep., Nr. 424/2 Kol. datë 26.03.2009 përpara Noteres dhe Kontratës Koncesionare Shtesë Nr. 270 Rep., Nr. 146 Kol. datë 10.05.2012 përpara Notere

Kjo Marrëveshje u hartua në 4 (kater) kopje dhe pasi ju lexua palëve, në prani të përkatës së gjuhës italiane të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lire e të plotë dhe një noterja e vërtetoi atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përfaqësuar nga:

Znj.



Përkatës

KONCESIONARI
GEOENERGIE S.P.A.
Përfaqësuar nga administratori
GEOENERGIE
Via Ca' Antonelli, 55 24024 GANDINO (Le) - It.
Tel +39 035 715811 Fax +39 035 715811
E-mail: info@geoenergie.it

SHOQERIA KONÇESIONARE
GEOALBANIA UNO Sh.p.k.
Përfaqësuar nga administratori:

GEOALBANIA UNO SH.P.K.
NIPT L02212002F

NOTER